



Republika e Kosovës
Ministria e Financave

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar

Buletini Ekonomik Tremujor Janar – Mars, 2019

Buletini Ekonomik Tremujor ofron një përditësim të disa prej zhvillimeve kyçe brenda disa sektorëve të ekonomisë. Buletini gjithashtu përshkruan zhvillimet fiskale për shtetin si dhe parashikimet më të azhurnuara të Departamentit. Buletini është dizajnuar me qëllim që të jetë edhe informativ dhe i arritshëm për të gjithë lexuesit. Buletini mund të përdoret për punime kërkimore ose për qëllime prezantimi, vetëm me citimin e burimit.

Përmbajtja

Zhvillimet e Ekonomisë së Jashtme	3
Ekonomia	4
Rritja Ekonomike	4
Inflacioni	6
SEKTORI I JASHTËM	7
Llogaria Rrjedhëse	7
Llogaria Financiare.....	9
SEKTORI FINANCIAR	9
TREGU I PUNËS.....	10
Anketa e Fuqisë Punëtore 2018.....	10
KLIMA E BIZNESIT	10
Bizneset e reja TM4 2018.....	10
Anketa e Odës Ekonomike Kosovare TM1 2019.....	10
Financat Publike	11
Informata të tjera: Ndikimi i taksës 100%.....	13
Ndikimi në importe	13
Ndikimi në të hyrat doganore	14

Zhvillimet e Ekonomisë së Jashtme

Rritja ekonomike botërore parashihet të ngadalësohet në 2019 mirëpo të stabilizohet në periudhën afatmesme.¹ Rritja botërore është ngadalësuar si rrjedhojë e tensioneve të vazhdueshme tregtare dhe rritjes së pasigurisë në disa fusha (siç janë masat mbrojtëse, dobësitë në Kinë, rezultati përfundimtar i Brexit dhe rrjedha e politikës ekonomike në Itali).

Rishikimet e rritjes² për Bashkimin Evropian pasqyrojnë tensionet tregtare dhe pasigurinë në përgjithësi. Përveç kësaj, ndikimi në kërkesën e brendshme si rrjedhojë e standardeve të reja të emetimit të karburantit të automjeteve në Gjermani dhe rreziqeve sovraane dhe financiare të Italisë kanë luajtur një rol në këtë ngadalësim ekonomik. Inflacioni në eurozonë ishte 1.4%³ në mars të vitit 2019, me kontribut më të madh të ardhur nga komponenti i energjisë (rreth +0.52 p.p.), pasuar nga shërbimet (me rreth +0.51 p.p), dhe nga komponenti i ushqimeve, pije alkoolike dhe duhan (me rreth +0.34 p.p). Normat më të ulta të inflacionit u regjistruan nga Portugalia (0.8%) dhe Greqia (1.0%), ndërsa normat më të larta të inflacionit u shënuan nga Rumania (4.2%), Hungaria (3.8%) dhe Holanda (2.9%). Përveç kësaj, në tremujorin e parë të vitit 2019, rritja ekonomike në euro zonë dhe BE u përshpejtua. BPV-ja reale e përshtatur sezonalisht u rrit për 1.2% në eurozonë dhe për 1.5% në BE 28, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar.⁴ Italia doli nga një recesion ekonomik në këtë tremujor, ndërsa Franca dhe Spanja kishin rritje më të lartë se sa pritej.

Tabela 1. Indikatorët kryesorë të ekonomisë botërore

v-m-v, %, nëse nuk ceket ndryshe	2018	2019	2020
BPV Botërore ^(FMN WEO Prill)	3.6	3.3	3.6
Inflacioni, çmimet mesatare të konsumit ^(FMN WEO Prill)	3.6	3.6	3.6
BPV në Euro Zonë ^(ECB Parashikimet Mars 2019s)	1.9	1.1	1.6
Inflacioni në Euro Zonë ^(ECB Mars 2019 proj.)	1.7	1.2	1.5

Pjesa më e madhe e çmimeve të energjisë, metaleve, mineraleve dhe produkteve bujqësore shënuan rritje në tremujorin e parë të vitit 2019. Çmimet e ulëta të energjisë, metalit dhe mineraleve në fund të vitit 2018 sugjeruan rritje më të ngadalësuar botërore, veçanërisht në Kinë për shkak të tensioneve tregtare. Megjithatë, për shkak të vazhdimit të negociatave tregtare mes SHBA-së dhe Kinës dhe stimujve fiskal në disa vende, perspektivat e rritjes u përmirësuan dhe çuan në rritjen e çmimeve.

¹ WEO Prill 2019

² WEO and European Commission

³ Eurostat

⁴ Ky rishikim në rritje bazohet në vlerësimet e publikuara nga Eurostat, zyra e statistikave të BE.

Tabela 2 Çmimet e komoditeteve

	2017				2018				2019
	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1
Indeksi i çmimeve të të gjitha komoditeteve (IMF commodity prices)	114.5	108.6	111.4	119.8	127.8	131.4	130.5	124.0	118.9
Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe pijeve. (IMF commodity prices)	105.6	103.7	102.5	101.1	105.4	106.0	98.7	98.2	98.9
Çmimi i naftës bruto, Brent (BB Pink Sheet)	54.1	50.2	51.7	61.5	67	74.5	75.5	67.4	63.3
Nikel, \$ për ton metrik (BB Pink Sheet)	10,2738,232	10,53211,601	13,28414,470	13,23911,463	12,412				

Sektori Real

Rritja Ekonomike


Ecuria Makroekonomike 2018

Në tremujorin e katërt të vitit 2018, ekonomia e Kosovës u rrit me 3.8% (v-m-v) në terma realë dhe me 4.5% (v-m-v) në terma nominalë.


Norma reale e rritjes në tremujorin e katërt të 2018-ës kryesisht i atribuohet investimit total (me një kontribut prej rreth 2.58 p.p.); konsumit privat (me 2.17 p.p.) dhe konsumit publik (me 0.17 p.p.); ndërkohë që kontributi i eksporteve neto të mallrave dhe shërbimeve vazhdoi të ishte negativ (rreth 1.12 pikë përqindje).

Bazuar në ndarjen sipas aktiviteteve ekonomike, sektori i shërbimeve ka kontributin më të lartë në rritjen reale të BPV-së në tremujorin e katërt të 2018-ës (rreth 1.9 pikë përqindjeje), që pasohet nga sektori i ndërtimit me 0.43 p.p. dhe sektori i bujqësisë me 0.17 p.p.; ndërkohë që industria vazhdon të kontribuojë negativisht me 0.33 p.p.

Grafiku 1 Kontributet në BPV



Grafiku 2 BPV reale sipas aktiviteteve



Bazuar në të dhënat preliminare tremujore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), rritja reale e BPV-së gjatë gjithë vitit 2018 ishte 3.9% krahasuar me vitin paraprak. Bazuar në të dhënat historike, publikimet vjetore për rritjen ekonomike janë zakonisht më të larta se ato tremujore.⁵ Prandaj, duke gjykuar mbi bazën e rishikimeve të rritjes ekonomike nga ASK dhe në ecurinë e burimeve të financimit të konsumit dhe investimeve dhe në ecurinë e bilancit tregtar pritet që rritja vjetore reale për vitin 2018 të jetë më e lartë, rreth 4.3%.

Pritjet për ecurinë makroekonomike për TM1 2019

- Në mungesë të të dhënave zyrtare nga ASK-ja për BPV në tremujorin e parë të 2019, indikatorët indirekt të kërkesës agregate japin sinjale të përziera.
- Rritja e konsumit privat në tremujorin e parë të 2019 mbështetet nga: i) rritja e importeve të mallrave të konsumit me 8.9%; ii) rritja e mbledhjes së TVSH-së prej 7.4%; iii) përmirësimi i klimës së biznesit në sektorin e shitjes me pakicë dhe shumicë; dhe iv) rritja e remitançave me 4.4%.
- Konsumi publik⁶ është rritur për 3.9% në tremujorin e parë të 2019 (v-m-v).
- Rritja e investimeve private në këtë tremujor mbështetet nga: i) rritja e importeve të mallrave kapitale me 14.8%; dhe ii) rritja e investimeve të huaja direkte me më shumë se 50%. Nga ana tjetër, indeksi i klimës së biznesit në 2019T1 është përmirësuar krahasuar me tremujorin e mëparshëm (2018 T4).
- Investimet publike në tremujorin e parë janë më të ulëta se ato të tremujorit të parë të vitit të kaluar për shkak të miratimit të vonshëm të Buxhetit 2019.
- Bilanci tregtar në dy muajt e parë të 2019 është ulur me 6.7% në terma vjetorë.

Parashikimet më të fundit ekonomike

Ministria e Financave publikoi parashikimet makroekonomike më të fundit në muajin prill, si pjesë e KASH 2020-2022. Këto parashikime së bashku me ato të institucioneve të tjera janë të përshtatshme në tabelën më poshtë.

⁵ Për 2016 dhe 2017, rritja reale ekonomike bazuar në të dhëna tremujore ishte 3.4% dhe 3.7% respektivisht, të cilat u rishikuan për lartë në publikimet vjetore në 4.1% and 4.2%, respektivisht.

⁶ Konsumi Publik përfshin dy kategori të shpenzimeve “paga dhe mëditje” dhe “mallra dhe shërbime”

Tabela 3 Parashikimet e institucioneve të tjera

Rritja e BPV % Parashikime	Data e Publikimit	2019	2020	2021	2022
Ministria e Financave	Prill 2019 ⁷	4.7	4.7	4.5	4.6
FMN	Prill 2019 ⁸	4.0	4.0	4.0	4.0
Banka Botërore	Mars 2019 ⁹	4.4	4.5	n/a	n/a
FMN BPV nominale në mln Euro	Prill 2019	7106.0	7507.0	7944.0	8420.0
MF BPV nominale në mln Euro	Prill 2019	7123.0	7520.4	7945.7	8392.2


Inflacioni

Në TM1 2019, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) u rrit për 3.2% në terma vjetorë. Kjo normë është më e lartë se norma e inflacionit e regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (rreth zero) dhe mbi normën mesatare për tërë vitin 2018 (1.1%). Nënkatëgoritë e IÇK-së që treguan rritjen më të lartë kishin:


- Kategoria e ushqimit me 2.51 p.p (kryesisht nga çmimet e "bukës dhe drithërave", "perimeve" dhe "mishit" ndërsa "frutat" kishin kontribut negativ);
- Kategoria e pijeve alkoolike dhe duhanit me 0.19 p.p;
- Transporti me 0.40 p.p (kryesisht nga kategoria "operimi i pajisjeve të transportit personal");

Inflacioni bazë në tremujorin e parë 2019, matur duke përjashtuar kategoritë "ushqim dhe pije jo-alkoolike" dhe "transporti", shënoi një rritje vjetore prej 0.6%, që është më e ulët se sa inflacioni total (3.2%), por më e lartë se vlera e vet mesatare e regjistruar në vitin 2018 (-0.1%).

Grafiku 3 Inflacioni dhe Inflacioni bazë



Grafiku 4 Kontributi i inflacionit të tregtueshëm dhe të patregtueshëm



⁷ MTEF 2020-2022

⁸ World Economic Outlook

⁹ <http://www.worldbank.org/en/news/press-release/2018/10/04/growth-in-kosovo-maintains-positive-momentum-says-world-bank>

Siç shihet në grafikun 4, komponenti i inflacionit të tregtueshëm vazhdon të përcaktojë sjelljen e inflacionit total dhe vlerësohet të ketë një kontribut rreth 2.9 pikë të përqindjes, ndërkohë që kontributi i komponentit të pa-tregtueshëm është shumë i ulët.

Tabela 4 Kontributet e kategorive kryesore në inflacionin vjetor

Nën kategoritë kryesore të IÇK	2016		2017		2018		2019
	mes.	mes.	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Ushqimi dhe pijet jo-alkoolike	-0.13	0.60	0.24	0.25	0.87	1.12	2.54
<i>prej të cilave: Ushqimi</i>	-0.20	0.46	0.19	0.27	0.89	1.15	2.51
<i>Buka dhe Drithërat</i>	-0.23	0.06	0.22	0.14	0.13	0.38	1.08
<i>Pemët</i>	-0.05	0.12	0.18	-0.02	-0.05	-0.19	-0.20
<i>Perimet</i>	-0.26	0.05	-0.10	0.12	0.43	0.46	0.93
Pijet alkoolike dhe duhani	0.44	0.18	0.09	0.13	0.13	0.16	0.13
<i>prej të cilave: Duhani</i>	0.35	0.19	0.10	0.09	0.09	0.08	0.11
Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	-0.38	0.36	0.04	0.37	0.75	0.83	0.40
IÇK (v-m-v, %)	0.28	1.48	-0.03	0.72	1.38	2.16	3.20

SEKTORI I JASHTËM


Llogaria Rrjedhëse

Deficiti tregtar i mallrave në tremujorin e parë të vitit 2019 është ende i lartë duke arritur vlerën 635.2 milionë €.

- Importi i mallrave gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 shënoi një rritje prej 8.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, i nxitur kryesisht nga rritja e importeve të mjeteve të transportit (17.3%, v-m-v); e importeve të produkteve minerale (8.5%, v-m-v) dhe importeve të plastikës (14.4%, v-m-v).
- Eksportet e mallrave gjatë tremujorit të parë 2019 shënuan një rritje prej 5.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Një rritje e tillë paraqet një përmirësim të konsiderueshëm në krahasim me ecurinë e dobët të eksporteve në vitin 2018 (rënie vjetore prej 2.8%), për shkak të ngadalësimit në eksportet e metaleve bazë dhe produkteve minerale. Rritja e eksporteve të mallrave në tremujorin e parë 2019 është nxitur kryesisht nga një rritje e eksporteve të produkteve minerale (22.2%, v-m-v); eksporteve të plastikës (17.7%, v-m-v); dhe eksportet e pajisjeve të makinerisë (53.8%, v-m-v). Gjithashtu, rritja e eksportit të mallrave është ndikuar nga një ngritje në çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare në 2019, pas një rënie në fund të vitit 2018.

Suficiti tregtar i shërbimeve për dy muajt e parë të vitit 2019¹⁰ është 55.5 milionë € dhe është rreth 1.6% më i ulët se bilanci në dy muajt e parë të vitit 2018. Kjo reflekton import dhe eksport më të ulët të shërbimeve.

Grafiku 5 Tregtia e mallrave dhe shërbimeve



○ Eksporti i shërbimeve për dy muajt e parë të vitit 2019 ishte 3.3% më i ulët se ai në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kryesisht për shkak të shërbimeve më të ulëta të udhëtimit.

○ Importi i shërbimeve ishte 4.6% më i ulët se ai i të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, për shkak të rënies së shërbimeve "të tjera të biznesit" dhe "udhëtimit".

Si rezultat i zhvillimeve në totalin e importeve dhe eksporteve, bilanci tregtar i mallrave dhe shërbimeve në periudhën janar-shkurt 2019 është 6.7% më i ulët se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Bilanci i të ardhurave parësore për dy muajt e parë të vitit 2019 është ulur, duke arritur një vlerë prej 11.3 milionë eurosh krahasuar me 25.0 milionë që ishte në periudhën e njëjtë të 2018, kryesisht si rezultat i të ardhurave më të ulëta nga kategoria e kompensimit të punëtorëve.

Bilanci i të ardhurave dytësore për dy muajt e parë të vitit 2019 arriti vlerën prej 181.4 milionë €, që është 3% më i lartë se bilanci gjatë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Kjo rritje është kryesisht për shkak të rritjes së remitançave neto (7.3%, v-m-v).


Si rezultat i zhvillimit të bilancit tregtar të mallrave dhe shërbimeve, bilancit të të ardhurave parësore dhe dytësore, deficiti i llogarisë rrjedhëse për dy muajt e parë të vitit 2019 është -93.5 milionë €, që reflektohet në bilancin e llogarisë rrjedhëse prej -67.7 milionë € në vitin 2018.

¹⁰ Të dhënat për tregtinë e shërbimeve janë të disponueshme vetëm për Janar-Shkurt 2019

Llogaria Financiare

- Bilanci i llogarisë financiare për dy muajt e parë të vitit 2019 është përmirësuar me rreth 30 milionë €. Kjo pasqyron rritjen e asetëve rezervë neto, ndërsa bilanci i letrave me vlerë është ulur.
- Gjatë dy muajve të parë të vitit 2019, hyrjet totale të IHD-ve arritën në rreth 44.7 milionë €, duke regjistruar një rritje vjetore prej rreth 55%.
- Rreth 65% e totalit të investimeve të huaja direkte gjatë periudhës janar- shkurt të vitit 2019 u absorbua nga sektori i pasurive të paluajtshme dhe qiratë.
- Ndërmjetësimi financiar vijon të jetë absorbuesi i dytë më i madh i IHD-ve, që përbën 25.8% të totalit të IHD-ve.

Grafiku 6 Investimet e huaja direkte, të hyrat në mln Euro



SEKTORI FINANCIAR

- Depozitat e reja në tremujorin e parë të vitit 2019 u rritën me 0.8% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2018. Ka pasur një rritje prej 59.1% në depozitat e korporatave jofinanciare dhe një rënie prej 10.5% në depozitat e ekonomive familjare.
- Kreditë e reja në tremujorin e parë ishin rreth 5% më të ulëta krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2018, duke reflektuar një rënie të kredive konsumuese për 15.7% dhe rënie të kredive për investime me 6.4%, ndërsa kreditë hipotekare shënuan rritje prej 9.9%;
- Norma efektive e interesit për kreditë e reja për tremujorin e parë të vitit 2019 ishte mesatarisht 6.7%, ndërsa gjatë tremujorit të parë të vitit të kaluar ajo ishte 6.9%. Kjo rënie u reflektua kryesisht në kreditë e lëshuara për ekonomitë familjare, ndërsa ato për kreditë e lëshuara ndaj korporatave jofinanciare mbetën relativisht të njëjta.
- Norma e interesit për depozitat e reja ka qenë mesatarisht 1.5% në tremujorin e parë të vitit 2019 krahasuar me 1.1% në të njëjtën periudhë të vitit 2018, e cila është reflektuar pothuajse në të gjitha maturitetet.
- Kreditë jo-performuese gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 ishin 2.6% të totalit të kredive, duke treguar një përmirësim nga tremujori i parë i vitit 2018, i cili kishte një raport të kredive jo-performuese prej 3.0%.

Tabela 5 Indikatorët e Sektorit Financiar


	2017				2018				2019
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1
Depozitat e reja % Δ	-10.4	2.4	21.8	3.9	20.6	19.0	17.9	36.1	0.8
Kreditë e reja % Δ	13.7	19.6	27.1	44.7	14.6	12.3	-3.7	0.7	-5.0
Norma efek. e in. në kredi të reja	7.3	6.7	6.6	6.8	6.9	6.7	6.7	6.3	6.7
Norma efek. e int. në dep. të reja	0.9	1.0	1.1	1.1	1.1	1.2	1.5	1.4	1.5
Kreditë jo-performuese	4.7	4.2	3.8	3.4	3.0	2.9	2.8	2.7	2.6

TREGU I PUNËS

Anketa e Fuqisë Punëtore 2018

- Të dhënat më të fundit të tregut të punës tregojnë se norma e punësimit në fund të vitit 2018 ishte 28.8%, nga 29.8% në fund të vitit 2017.
- Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ra në 40.9% në vitin 2018 nga 42.8% në fund të vitit 2017.
- Ndërsa, norma e papunësisë në vitin 2018 ra në 29.6%, nga 30.5% në fund të vitit 2017.
- Këto zhvillime kryesisht i atribuohen daljes së punëtorëve apo të papunëve nga fuqia punëtore.

Grafiku 7 Indikatorët e tregut të punës



KLIMA E BIZNESIT


Bizneset e reja TM4 2018

- Numri i bizneseve të reja gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018 është 2,401 dhe është 24.9% më i lartë se numri i bizneseve të regjistruara gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017.
- 561 biznese të reja janë regjistruar në kategorinë e tregtisë, 280 biznese të reja në kategorinë e prodhimit, 252 biznese të reja në akomodim dhe shërbime ushqimore, 244 biznese të reja në ndërtim dhe pjesa tjetër në kategori të tjera.


Anketa e Odës Ekonomike Kosovare TM1 2019

- Rezultatet e indeksit të klimës së biznesit për tremujorin e parë të vitit 2019 tregojnë se bizneset kanë pikëpamje të përgjithshme pozitive të klimës së biznesit dhe indeksi i klimës së biznesit është përmirësuar nga 38 në tremujorin e fundit të vitit 2018 në 39 gjatë këtij tremujori.
- Të gjithë sektorët kanë pritshmëri pozitive për punësim për gjashtë muajt e ardhshëm.
- Sektori i prodhimit, i shitjes me shumicë dhe ai i shërbimeve e vlerësojnë klimën si pozitive dhe me përmirësim ndërkohë që sektori i shitjes me pakicë dhe ai i ndërtimit e vlerësojnë klimën e biznesit si pozitive por me përkeqësim.


Grafiku 8 Indeksi i klimës së biznesit



Grafiku 9 Pritjet për punësim



Grafiku 10 Pritjet e klimës së biznesit



Financat Publike


Të dhënat Fiskale

- Të hyrat e përgjithshme arritën në 388.6 milionë për periudhën janar-mars 2019, një rritje vjetore prej 10.4% ose 36.5 milionë euro krahasuar me periudhën deri në fund të marsit 2018. Ky arkëtim paraqet një normë realizimi prej 99.2% të shumës së parashikuar për këtë periudhë.
- Të hyrat tatimore për këtë periudhë përbënin 342.8 milionë ose një rritje prej 10.2% krahasuar me vitin paraprak. Këto të hyra arritën 99.1% të të hyrave të parashikuara për këtë periudhë.
- Të hyrat jo-tatimore për këtë periudhë përbënin 45.8 milionë ose një rritje prej 11.4% krahasuar me një vit më parë. Këto të hyra arritën 100% të vlerës së parashikuar për këtë periudhë.
- Shpenzimet buxhetore deri në fund të marsit 2019, arritën vlerën prej 390.1 milionë euro dhe ishin rreth 15.4% më të ulëta se sa projeksionet.


Bilanci i përgjithshëm buxhetor

- Bilanci i përgjithshëm buxhetor (sipas rregullës fiskale) për tremujorin e parë ishte 1.6 milionë € ose afër zero si përqindje e BPV-së.
- Bilanci Bankar (sipas rregullës fiskale) për këtë tremujor ishte 450.1 milionë euro ose 6.3% e BPV-së.
- Bilanci i përgjithshëm buxhetor për vitin 2019 pritet të arrijë deficitin prej 145.3 milionë euro ose 2.0% të BPV-së, ndërkohë që Bilanci Bankar parashikohet të arrijë në 340 milionë euro ose 4.8% e BPV-së për 2019.

Grafiku 11 Kontributet në të hyrat buxhetore



Grafiku 12 Kontributet në shpenzime buxhetore



INFORMATA TË TJERA: NDIKIMI I TAKSËS 100% NDAJ SERBISË DHE BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS

Ndikimi në importe


Sipas të dhënave të BQK-së mbi importin sipas kategorive ekonomike dhe vendeve, për periudhën para vendosjes së taksës (Janar – Tetor, 2018), rezulton se produktet minerale janë produktet që më së shumti importohen në Kosovë (15%), për t'u ndjekur nga importi i makinerive, veglave, pajisjeve elektrike, etj. (13%), artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani (12%), dhe metalet bazë dhe artikujt prej tyre (12%).



Sipas origjinës së importeve, pjesëmarrja me e madhe në totalin e importeve gjatë periudhës së njëjtë (janar– tetor, 2018) ka qenë e dominuar kryesisht nga Serbia me 13.3%, më pas Gjermania me 11.7%, Turqia me 9.9%, Kina me 9.2% pasuar nga Italia me 6.2%, Shqipëria me 6.1% dhe Maqedonia me 5%.

Produktet më të importuara nga Serbia janë ato minerale (24% e total importeve nga Serbia), të pasuara nga kategoria e ushqimoreve, pijeve dhe duhanit (23%), metaleve bazë (9%), perimeve (rreth 9%), produkteve të industrisë kimike ose të industrive të ngjashme (7%) dhe produkteve të tjera (28%).

Për të analizuar më mirë efektin e taksës në zhvendosjen e importeve të Kosovës, janë analizuar kategoritë kyçe të importeve nga Serbia në dy periudha kohore (para taksës 100% dhe pas taksës), dhe duke u fokusuar në performancën e shteteve kyçe (dhe atyre që kanë përfituar nga taksa në fjalë) sipas kategorive të produkteve (të identifikuar më lartë) gjatë këtyre dy periudhave. Grafiket e mëposhtëm tregojnë qartësisht se pjesëmarrja e importeve nga Serbia dhe Bosnja, është zëvendësuar me importet nga vendet e tjera.

Grafiku 13 (a,b,c,d) Importi sipas vendeve dhe produkteve





Ndikimi në të hyrat doganore

Në bazë të të dhënave nga dogana, importi i rregullt i mallrave nga Serbia dhe nga Bosnja e Hercegovina gjatë periudhës janar- prill 2019 ka shënuar rënie prej më shumë se 98% dhe 92%, respektivisht, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Bazuar mbi shënimet e Doganës, për periudhën janar-prill 2019 rreth 1.03 milionë Euro të hyra doganore janë inkasuar nga Dogana për vlerën e importeve me origjinë Serbinë¹¹, ndërkohë që në periudhën e vitit të kaluar janë inkasuar rreth 30.32 milionë Euro. Ndërsa, për vlerën e importeve me origjinë Bosnja e Hercegovinën për periudhën janar- prill 2019 janë inkasuar rreth 0.47 milionë Euro, ndërkohë që në periudhën e vitit të kaluar janë inkasuar rreth 6.9 milionë Euro. Në total, në periudhën janar- prill 2019 kemi inkasuar rreth 35.7 milionë Euro më pak se në periudhën e vitit të kaluar për importet nga të dyja vendet, si rezultat i taksës prej 100%.

Tabela 6 Importet dhe të hyrat doganore nga Serbia dhe BeH

<i>mln Euro</i>	Importet nga Serbia (Vlera)	Dogana	Akciza	TVSH	Të Tjera (MP, MB dhe KK)	Totali Të Hyra Doganore
Janar- Prill 2018	134.8	0.1	12.4	17.6	0.1	30.3
Janar- Prill 2019	2.4	0.0	0.0	0.2	0.8	1.0
Dif. 2019/2018	-132.4	-0.1	-12.4	-17.4	0.7	-29.3
<i>mln Euro</i>	Importet nga BeH (Vlera)	Dogana	Akciza	TVSH	Të Tjera (MP, MB dhe KK)	Totali Të Hyra Doganore
Janar- Prill 2018	20.8	0.0	3.1	3.8	0.0	6.9
Janar- Prill 2019	1.6	0.0	0.0	0.3	0.2	0.5
Dif. 2019/2018	-19.3	0.0	-3.1	-3.5	0.2	-6.4

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur importet në vlerë (mln Euro) sipas shteteve kryesore që kanë shënuar rritjen më të madhe vjetore në periudhën janar- prill 2019. Vihet re që importi total nga vendet, si: Turqia, Greqia, Gjermania, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Sllovenia është

¹¹ Importi i naftës dhe benzinës përbën 9.3% të totalit të importit nga Serbia për Janar-Prill, 2018, ndërsa pjesëmarrja në të hyrat e inkasuara nga importi i këtyre dy produkteve përbën rreth 50% të totalit të të hyrave doganore për importet nga Serbia..

rritur në mënyrë të ndjeshme në periudhën janar- prill, 2019 duke u rritur me rreth 44.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tabela 7 Importet nga vendet e tjera

Vendi	Importet	Importet		Importet		Importet		Diferenca në Importe (Aktual- Vlerësim)
	Janar- Prill 2017	Janar- Prill 2018	v-m- v,	Janar-Prill 2019 Aktual	v-m-v,	Janar- Prill 2019 Vlerësim	v-m-v,	
	mln Euro	mln Euro		mln Euro		mln Euro		mln Euro
Turqia	82.4	91.1	10.6%	120.1	31.9%	100.7	10.6%	19.5
Greçia	36.8	38.7	5.1%	65.7	69.8%	40.7	5.1%	25.0
Gjermania	109.0	104.3	-4.4%	129.4	24.1%	104.3	0.0%	25.1
Shqipëria	42.3	41.1	-3.0%	65.6	59.7%	41.1	0.0%	24.5
Maqedonia e Veriut	42.0	44.4	5.8%	68.3	53.9%	46.9	5.7%	21.4
Sllovenia	17.8	22.9	28.7%	45.4	98.4%	29.5	28.7%	16.0
Total	330.3	342.3	3.7%	494.5	44.4%	363.0	3.7%	131.5

Për të matur ndikimin e taksës 100% ndaj produkteve të Bosnjës e Hercegovinës dhe Serbisë, është vlerësuar një skenar ku importi i shteteve të paraqitura do të ndiqte ecurinë e rritjes së vitit të kaluar (2018). Përfundimisht bëjnë ato shtete, të cilat në periudhën janar- prill 2018 kanë shënuar rritje negative dhe për të cilat është supozuar rritje zero për periudhën janar- prill 2019. Nën këtë skenar, nëse këto shtete do të rriteshin me këtë ritëm rritje të supozuar, importi total i këtyre vendeve do të ishte rreth 131.5 milionë Euro më pak se importi aktual. Duke supozuar një normë efektive tatimore të ngjashme si vitin e kaluar, të hyrat doganore që do të përkonin me këtë diferencë të importeve do të ishin rreth 42.7 milionë Euro.

Si rezultat i këtyre llogaritjeve, vihet re që efekti negativ në të hyrat doganore nga importet me origjinë Serbinë dhe Bosnjën e Hercegovinën -35.7 milionë Euro është kompensuar nga rritja e importeve nga vendet e tjera, me efekt shtesë në të hyrat doganore me +42.7 milionë Euro. Rrjedhimisht efekti neto në të hyrat doganore për këtë periudhë rezulton të jete rreth 7 milionë Euro më të larta si rezultat i aplikimit të taksës 100%, vetëm nga importi i shteteve të analizuar (që përbën 50% të importi total).